



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**  
**KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË**

Nr 3556/20 prot

Datë, 23 / 07 /2018

**VENDIM**

Nr. 27 Datë 12 / 07 /2018

**PËR**

**KËRKESËN DREJTUAR SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR PËR NJË STUDIM HIDROGJEOLOGJIK, MBI GJËNDJEN DHE MUNDËSITË E SHFRYTËZIMIT TË REZERVAVE UJORE NËNTOKËSORE NË BASENIN UJOR ISHËM ERZEN**

Në zbatim të ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" përkatësisht neni 12 pika, ligjit nr 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë" Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" neni 4 pika 12, Vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen në mbledhjen e datës 12.07.2018 gjatë shqyrtimit të kërkesave për leje hapje pus shpimi dhe rinovimit të përdorimi të puseve të shpimit ,

**KONSTATOI SE:**

Në zonën industriale Tiranë-Durrës, Kashar të basenin Ujor Ishëm - Erzen ka kërkesa të shumta për leje hapje pus shpimi si dhe kërkesa për përdorim të burimeve ujore nga puset e hapura në këtë rajon, zonë në të cilën ndodhen dhe puset e shpimit të UK Tiranë që përdoren për furnizimin me ujë të pijëshëm të popullsisë. Gjithashtu është konstatuar shfrytëzimi i ujrave nëntokësore nga një numër i madh biznesesh e familjarë nëpërmjet puseve të shpimit.

Me qëllim marrjen e vendimeve të drejta në të ardhmen dhe mbrojtjen nga ana cilësore dhe sasiore të trupave ujorë të akuifereve të ujrave nëntokësorë, me propozim të anëtarëve nëpërmjet Kryetarit, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

**V E N D O S I :**

1.Paraqitjen e kërkesës pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për një studim në lidhje me trupat ujorë të akuiferëve nëntokësorë në Basenin Ujor Ishëm-Erzen, ku të vlerësohet situata për:

- a) Shpërndarjen në hartë të akuiferëve brenda kufinjëve administrative të basenit ujqor Ishëm-Erzen dhe të dhëna pikësore mbi sasinë dhe cilësinë e tyre;
- b) Identifikimi në hartë i presioneve të mundshme dhe zonave nën risk;
- c) Përcaktimi i zonave ku duhet të ndërpritet shfrytëzimi i ujërave nëntokësore, zonave ku duhet të kufizohet shfrytëzimi, përcaktimi i sasisë maksimale që duhet të shfrytëzohet në këto të fundit dhe kufizime të tjera për tu pasur në konsideratë;
- d) Zona ku duhet të ndalohet dhënia e lejeve të reja për shfrytëzim dhe kriteret përkatëse që duhet të zbatohen me mbrojtjen e akuiferit;
- e) Masat të tjera që duhet të merren për ruajtjen e rezervave ujore nëntoksore të basenit ujqor Ishëm-Erzen.

2.Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin e këtij vendimi të Basenit Ujqor Ishëm-Erzen.

### PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

**SEKRETAR**

**Dorina ÇAPUNI**



**KRYETAR**

**Suzana JAHOLLARI**

